



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:069538

Datë: 11.07.2024

Numri i dokumentit: 05924752

SCC-09-0229

Paditësi: Korporata Energjetike e Kosovës, sh.a me seli në Prishtinë.

Kundër

Palës së paditur; Ndërmarrja e Pylltarisë dhe Industrisë së drurit Radusha me seli në Istog e cila administrohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga Drita Hoxha nr.55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykata Supreme e Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përmes gjyqtarit gjyqtarit kryesues Asllan Krasniqi, si dhe gjyqtarëve anëtar; Agron Hoxhaj dhe Bajram Miftari, në seancën vendimarrëse, me datën; 09.07.2024, merr këtë;

**A K T V E N D I M**

Hudhet poshtë si e papranueshme padia e parashtruar nga paditësi Korporata Energjetike e Kosovës, sh.a me seli në Prishtinë.

*Rrethanat faktike dhe procedurale*

Ndërmarrjes Pyjore Industriale Radusha me seli në Istog me datën; 18.12.2009 ka ushtruar padi për vërtetimin e pronësisë në bazë të parashkrimit fitues lidhur me ngastrat kadastrale që evidentohen me numër ..dhe . në sipërfaqe të përgjithshme prej; 0.55.75 ha, si dhe sipërfaqën prej; 314 m<sup>2</sup> për objektin e HC, për të cilat ngastra ka kërkuar nga gjykata vërtetimin e të drejtës pronësore në bazë të parashkrimit fitues tija njoh të drejtën pronësore dhe të njëjtat të regjistrohen në regjistrat përkatës në emër të palës paditëse Ndërmarrja e Pylltarisë dhe Industrisë së Drurit Radusha me seli në Istog, si dhe ka kërkuar nga gjykata kompensimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore.

Dhoma e Posaçme e Gjykata Supreme e Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit me datën; 26.04.2024, ka hartuar urdhër me shkrim me të cilin e ka detyruar të autorizuarin e palës paditëse që në afatin prej 15 ditëve duke llogaritur nga data e pranimit të urdhrit që të deklarohet lidhur me pretendimet e palës së paditur të cekura në seancën e mbajtur

me datën;24.04.2024 me të cilën e njëjta ka njohtuar gjykatën se Bordi i Drejtorëve të AKP-së me datën;30.11.2023 ka marrë vendimin e saj që evidentohet me numër Ref-BD-191/6 me të cilin vendim është vendosur që të gjitha pronat të cilat evidentohen në emër të Ekonomisë së Pyjeve dhe të Ekonomisë së Gjuetisë të largohen nga menaxhimi i AKP-së dhe të njëjtat kanë kaluar nën menaxhimin e Agjencisë së Pyjeve të Kosovës.

Pala paditëse është përgjigjur ndaj urdhërit të kësaj gjykate me datën;22.05.2024 me të cilën parashtrës të hartuar me shkrim ka potencuar se pala paditëse është e gatshme të tërhiqet padinë e saj ndaj të paditurës AKP,mirëpo paraprakisht ka kërkuar që Qeveria e Kosovës të pranon të jetë palë ndërgjyqëse dhe të pranoj se ajo ka kompetencë të plotë për të gjitha të drejtat dhe detyrimet për ish Ndërmarrjen Industriale Radusha me seli në Istog.

### Arsyetimi ligjor

Në rastin konkret gjykata duke iu referuar vendimit të marrë nga Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit që evidentohet me numër Ref-BD-191/6 të datës;30.11.2023, ka vlerësuar se në rastin konkret Agjencia nuk legjitimitet real pasiv në këtë çështje juridike kontestimore pasi që sipas këtij vendimi thuhet që largohen nga administrimi i AKP-së të gjitha pronat që evidentohen në emër të Ekonomisë së Pyjeve dhe Ekonomisë Gjuetisë,ku ndër to janë edhe pronat e Ndërmarrjes Pyjore Industriale Radusha me seli në Istog që këtij vendimi i është bashkëngjitur edhe momerandumi për Bordin e Drejtorëve dhe shkresa me emër Informata mbi Ekonominë Pyjore të Kosovës ku në faqen 10 pika 1.5 evidentohet edhe Ndërmarrjes Pyjore Industriale Radusha me seli në Istog që në rastin konkret është palë paditëse, andaj edhe bazuar në dispozitën e nenit 5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës gjykata ka ardhur në përfundimin se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për ta hedhur padinë e parashtruar nga parashtruesi i saj, andaj edhe është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

### Këshilla Juridike

Ndaj këtij aktvendimi paditësi mund të ushtroj ankesë me shkrim duke iu drejtuar Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës në afatin kohor prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve duke llogaritur nga data e pranimit të këtij aktvendimi,.

Asllan Krasniqi-Gjyqtar kryesues

Agron Hoxha-Gjyqtar anëtar

Bajram Miftari-Gjyqtar anëtar